



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1935/13 Prot.

Tiranë, më 07-08 2023

V E N D I M

Nr. 57 datë 07-08 2023

“PËR

**PEZULLIMIN E PJESSHËM TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR.31, DATË 30.06.2022 “PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT TË PROJEKTEVE SHKENCORE TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS”**

Bordi i Administrimit të Universitetit Sporteve të Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 07.08.2023, referuar:

- Problematikave të parashtruara me Relacionin nr. 1812, datë 14/07/2023, me lëndë; **“Relacion mbi problematikën e hasur dhe pezullimin e aktiviteteve të Projektit Kërkimor-Shkencor “65 vjet trashëgimi dhe histori e UST-së në lanten e kërkuesve dhe studiuesve multidisiplinar”**,
- Konstatimit të mungesës në zyrën e arkivë/protokollit të UST të dokumentacionit shoqëruar të vendimit të BA nr.31, datë 30.06.2022 “Për miratimin e financimit të projekteve shkencore të UST-së”,

në përfundim të diskutimeve dhe mbështetur në nenin 49 të ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 44 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës;

**VENDOSI;**

1. Pezullimin e financimit të aktiviteteve të Projektit Kërkimor-Shkencor “65 vjet trashëgimi dhe histori e UST-së në lanten e kërkuesve dhe studiuesve multidisiplinarë”, të miratuar sipas pikës 1, paragrafi 1 të Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 31, datë 30.06.2022 “Për miratimin e financimit të projekteve shkencore të UST-së”.

2. T'i kërkojë Senatit Akademik dhe strukturave përgjegjëse të Universitetit të Sporteve të Tiranës, rivlerësimin e veprimtarive dhe të efekteve financiare të projektit kerkimor-shkencor “65 vjet trashëgimi dhe histori e UST-së në lanten e kërkuesve dhe studiuesve multidisiplinarë”, të miratuar sipas pikës 1, paragrafi 1 të Vendimit të Senatit Akademik të UST nr. 59, datë 28.06.2022 “Për miratimin e projekteve shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës për vitin akademik 2021-2022”.
3. T'i kërkojë Senatit Akademik dhe strukturave përgjegjëse të Universitetit të Sporteve të Tiranës, që financimi për realizimin e veprimtarive të projektit “65 vjet trashëgimi dhe histori e UST-së në lanten e kërkuesve dhe studiuesve multidisiplinarë”, të planifikohet vetëm për kontributin dhe shërbimet që do të ofrohen dhe pranohen nga palët e treta.
4. T'i kërkojë Senatit Akademik dhe strukturave përgjegjëse të Universitetit të Sporteve të Tiranës, që pjesëmarrja dhe kontributi i personelit akademik dhe administrativ të UST në realizimin e veprimtarive të këtij projekti, të konsiderohet kontribut institucional që prej miratimit dhe fillimit të veprimtarive në kuadër të këtij projekti.
5. Të miratojë realizimin e detyrimeve financiare të krijuara me palët e treta për shërbimet e ofruara në kuadër të realizimit të këtij projekti deri në datën e miratimit të këtij vendimi.
6. Afati kohor i pezullimit sipas këtij vendimi, shtrihet deri në miratimin e rivlerësimit nga strukturat përgjegjëse të veprimtarive dhe efekteve financiare të projektit “65 vjet trashëgimi dhe histori e UST-së në lanten e kërkuesve dhe studiuesve multidisiplinarë”, sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.
7. Ky vendim i njoftohet Rektorit dhe Administratorit të UST-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, dhe publikohet në faqen zyrtare të UST dhe tek transparenca universitare.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**ARTUR COBANI**

